




Harta e Kosovës me zonat e veprimit të Logosi-it



■ Komunat Partnere

 Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development and Cooperation SDC

implemented by:
inter cooperation
Natural Resource Management
Rural Economy
Local Governance and Civil Society

Zvicër-Kosovë

Përkrahja për Qeverisje Lokale dhe Decentralizim

LOGOS

Qeverisja e mirë është edhe një çështje tjetër e rëndësishme ndër-sektoriale, që i ka pesë dimensione të rëndësishme: përgjegjësinë, transparencën, pjesëmarrjen, jo-diskriminimin dhe efikasitetin. Këto parime kyçe janë të integruara në LOGOS, të cilat drejt-përdrejt fuqizohen përmes tri fushave kryesore të punës. Si shtesë e këtyre pesë parimeve një theks i veçantë i jepet përfshirjes së komuniteteve. Kjo qasje e ndjeshme ndaj komuniteteve siguron qasje të barabartë të komuniteteve të ndryshme në procesin e vendimmarrjes dhe buxhetimit në qeverisjen lokale.

Niveli nën komunal është njëra nga tri çështjet ndër-sektoriale për fazën e II-të të LOGOS-it. Projekti siguron se prioritetet e nivelit nën-komunal janë marrë parasysh nga ana e komunave duke qenë pjesë e proceseve të tyre të planifikimit strategjik dhe buxhetimit.



Nazim Gafurri str. 33
Po Box no.2
10000 Pristina, Kosovo
<http://www.intercoopkos.org/logos>

Tel: +381(0) 38 51 77 15
Tel: +381(0) 38 51 66 44
Fax: +381(0) 38 51 88 33
info@intercoopkos.org

Rreth LOGOS-it

Zvicër-Kosovë Përkrahja për Qeverisje Lokale dhe Decentralizim (LOGOS) është pjesë e programit shtetëror të Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) në Kosovë. Projekti ka filluar së vepruari në 2007 dhe tani është në fazën e II-të të realizimit (2010-2012).

LOGOS kontribuon në forcimin e qeverisjes lokale dhe reformave të decentralizimit në nëntë komuna në juglindje të Kosovës. Kontribuon në demokratizim dhe në pjesëmarrjen e qytetarëve në një shtet multietnik. Në kuadër të këtij qëllimi të zhvillimit të përgjithshëm, rezultati i pritur nga ky projekt është që komunat partnere të zgjedhura në juglindje të Kosovës të jenë më të përgjegjshme, transparente, të barabarta dhe efektive në qeverisje lokale dhe të jenë në gjendje të ofrojnë shërbime që të plotësojnë nevojat e të gjitha grupeve të qytetarëve. Rezultati i projektit ndiqet përmes përqendrimit në këto fusha punuese si në vazhdim:

- Planifikimi strategjik dhe hapësinor
- Planifikimi i buxhetit
- Të hyrat vetanake
- Menaxhimi i mbeturinave
- Struktura Komunale
- Barazia gjinore

Për veç kësaj, LOGOS-i ka një fond për investime, i cili është hartuar për të mbështetur financiarisht projektet nga komunat partnere.

LOGOS faza e II-të ka buxhetin prej 3.2 milion Euro. Këtu përfshihen edhe 900000 Euro për fondin e investimeve.

LOGOS faza e II-të ka partnerë komunat në vazhdim: Hanin e Elezit, Kaçanikun, Kamenicën, Kllokotin – Vërbovc, Novobërdën, Parteshin, Ranillugun, Shtërpcën dhe Vitinë.

1. Aktivitetet Mbështetëse

LOGOS-i kombinon metoda të ndryshme për të përkrahur punën e komunave dhe zhvillimin e kompetencave të tyre. Projekti këshillon komunat dhe ofron trajnime për zyrtaret komunalë dhe këshillime (në vendin e punës) duke përfshi këtu vizita studimore relevante në vende tjera gjithashtu edhe në rajon.

Projekti mbështet punën e gjitha komunave në fushën e planifikimit të buxhetit, analizat dhe rritjen e të hyrave vetanake komunale. LOGOS-i gjithashtu është aktiv në mbështetjen e komunave në marrëdhëniet me qytetarët dhe me nivelin nën-komunal me qytetarët në promovimin e barazisë gjinore.



Disa aktivitete tjera mbështetëse janë specifike për çdo komunë. LOGOS-i promovon një qasje nga kërkesat e drejtuara që të përputhë mbështetjen e ti për nevojat specifike të secilës komunë partnere. Projekti gjithashtu investon në forcimin e bazës teknike të administratave komunale të Kllokotit - Vërbovc, Ranillugut, Novobërdës, Shtërpcës dhe Parteshit, të cilat janë komuna të krijuara në kohën e fundit (sapokrijuara). LOGOS gjithashtu mbështet edhe gjashtë komunat partnere (Kamenicë/Kamenica, Novo Brdo/Novobërdë, Štrpce/Shtërpcë, Kaçanik/Kaçanik, Ranilug/Ranillug dhe Klokot - Vrbovac/Kllokot - Vërbovc) në zhvillimet e nevojshme ligjore të planeve strategjike dhe hapësinore: Planet zhvillimore komunale (PZHK), Planet zhvillimore urbane (PZHU), Planet rregulluese urbane (PRU) me fokus të veçantë në përfshirjen e shoqërisë civile.

LOGOS mbështet komunat e Vitisë dhe Hanit të Elezit në vlerësimin e sistemit aktual të menaxhimit të mbeturinave, trajnimin e tyre se si ti mbledhin dhe analizojnë të dhënat, elaborimin e planit integruar për menaxhimin e mbeturinave të ngurta (PMMN) me pjesëmarrje.

Këto aktivitete të synuara gjithashtu mundësojnë identifikimin e praktikave të mira që mund të përsëriten në komunat tjera partnere në gjithë Kosovën.

2. Fondi investiv:

LOGOS ka krijuar një fond për investime për të mbështetur komunat në tejkalimin e mundësive të tyre të kufizuara për të investuar në projekte kapitale. Projektet propozohen dhe menaxhohen nga komunat dhe pastaj komunat ndihmohen që të planifikojnë buxhetin për ato projekte.

Fondi është i ndarë në tri komponenta:

- Një projekt me fillim të shpejtë në çdo komunë partnere
- (Së paku) dy projekte komunale në çdo komunë partnere
- Një projekt për barazinë gjinore në çdo komunë partnere

Fillimisht, komunat partnere priten të përcaktojnë koncept projektet përmes konsultimeve të shumta në nivel lokal dhe në bazë të kriterëve të përcaktuara nga LOGOS-i. Pasi që koncepti është përzgjedhur, LOGOS-i siguron mbështetje për komunat në mënyrë që të përkthehen koncept projektet e përzgjedhura në projekt propozime të kompletuar, ku do të vendosen të dhënat e projektit që do të financohet.

3. Çështjet e tërthorta:

Barazi gjinore, qeverisja e mirë dhe përfshirja e nivelit nën komunal janë tri çështjet ndër-sektoriale të punës së LOGOS-it.

LOGOS-i përfshinë çështjet mbi barazinë gjinore duke i mbështetur qeveritë lokale në zbatimin në praktikë të Ligjit Mbi Barazinë Gjinore. Siguron angazhimin e grave në vendim-marrje dhe në procesin e buxhetimit që është një parakusht i rëndësishëm për fuqizimin e tyre, si për zhvillimin e qëndrueshëm dhe të balancuar lokal. Përveç kësaj, femrat tradicionalisht kanë luajtur një rol të rëndësishëm në procesin e pajtimit.

